



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

Raporti i vetëvlerësimit

2017-2018

Komisioni i vetëvlerësimit
UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE | NËNTOR 2018

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	4
2.	Të arriturat.....	5
3.	Struktura: fakultetet dhe qendrat.....	5
3.1.	Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë	6
3.2.	Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore.....	6
3.3.	Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore	7
3.4.	Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit	8
3.5.	Fakulteti i Drejtësisë.....	8
3.6.	Qendra e Gjuhëve.....	9
3.7.	Qendra E-Learning	10
4.	Sigurimi i cilësisë.....	10
5.	Mësimdhënia dhe të mësuarit.....	11
5.1.	Programet dhe statusi	11
5.2.	Regjistrimi i studentëve.....	11
5.3.	Kalueshmëria e studentëve.....	13
5.4.	Qendra e karrierës dhe punësueshmëria.....	14
5.5.	Asociacioni Alumni.....	15
6.	Hulumtimi	15
6.1.	Instituti hulumtues “Max Van der Stoel”	16
6.2.	Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit.....	17
6.3.	Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare.....	18
7.	Ndërmarrësia dhe zhvillimi.....	18
8.	Financimi	20
9.	Mjedisi dhe shërbimet në kampus.....	21
9.1.	Mbështetja studentore.....	21
9.2.	Ngrehinat dhe kapacitetet teknike	21
9.3.	Kampusi i UEJL-së në Shkup	22
9.4.	Burimet njerëzore	23
9.5.	Sistemet e informacionit.....	25
9.6.	Shërbimet e bibliotekës	26
9.7.	Parlamenti dhe Asociacioni Studentor.....	27
9.8.	Sporti dhe rekreacioni	28
10.	Konkluzionet.....	30
	Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit	31

1. Hyrje

Ky raport e përfshinë periudhën kohore nga 1 shtatori 2017, deri më 31 gusht 2018. Gjatë kësaj periudhe, Universiteti e ka shënuar përvjetorin e gjashtëmbëdhjetë.

Universiteti i Evropës Juglindore ofron studime në tri cikle (deridiplomike, magjistraturës dhe doktoraturës), në pesë fakultete: Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë; Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore; Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore; Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit; dhe Fakulteti i Drejtësisë. Universiteti ka kampuse në dy lokacione, në Tetovë dhe në Shkup. Universiteti gjithashtu ka dy qendra të specializuara, Qendrën e Gjuhëve (për instruksione të gjuhëve) dhe Qendrën e-Learning (për zhvillimin dhe zgjerimin e shkathtësive kompjuterike). Universiteti vepron në bazë të 'përdorimit fleksibël të politikës gjuhësore' dhe të gjitha dokumentet dhe procedurat formale zhvillohen në tri gjuhët zyrtare në nivel të Universitetit: shqip, anglisht dhe maqedonisht. Megjithëse shumica e studentëve vijnë nga Republika e Maqedonisë, UEJL vazhdon të tërheqë studentë të shumtë nga Kosova, Lugina e Preshevës dhe Shqipëria, veçanërisht për programet në studimet pasuniversitare.

Universiteti angazhohet dhe bënë përpjekje të shumta për të ofruar ndihmë dhe mbështetje për studentët. Të gjitha fakultetet kanë këshilltarë studentor të dedikuar dhe një këshilltar i veçantë për studentët në studimet e magjistraturës. Parlamenti Studentor zhvillon zgjedhje të hapura dhe përfaqësuesit e zgjedhur marrin pjesë në një shumëllojshmëri të gjerë të funksioneve të Universitetit, duke filluar nga ekipet e cilësisë së fakulteteve deri në Senatën e Universitetit. Universiteti ka Qendrën e Karrierës që ofron trajnime për kërkimin e vendeve të punës, kryen intervista praktike, i shpërndan njoftimet për punësim, e drejton 'panairin e karrierës' dhe i mbikëqyr mundësitë për punë praktike. Disa studentë kontribuojnë në financimin e studimeve të tyre, duke marrë pjesë në programin "puno dhe studio", ku një pjesë e shkollimit të studentëve mund të paguhet duke punuar për Universitetin. Parku Teknologjik ofron mundësi të inkubacionit të biznesit për sipërmarrësit e rinj, duke u lejuar atyre qasje në shkathtësitë dhe burimet e Universitetit në fazat fillestare të përpjekjeve të reja.

UEJL, mbetet i përkushtuar ndaj misionit të tij për të ofruar arsimim të shkëlqyer, pavarësisht gjuhës amtare, gjinisë, përkatësisë etnike, fesë, apo bindjeve politike. Megjithatë, duhet pranuar se rrethanat e përgjithshme për arsimin e lartë në Republikën e Maqedonisë mbeten sfiduese. Ka shumë universitete shtetërore, që ofrojnë mundësi relativisht të lira arsimore. Gjenerata e studentëve të ardhshëm në studimet deridiplomike kanë lindur kryesisht në vitin 2000 ose 2001, të cilët kanë qenë vite të pasigurisë dhe njëkohësisht vite të reduktimit të lindjeve në Republikën e Maqedonisë. Ky trend, i kombinuar me përshpejtimin e emigrimit nga Republika e Maqedonisë, do të thotë se pakjoja e studentëve në dispozicion është më e vogël se ajo që ka qenë në të kaluarën e afërt.

Pavarësisht nga natyra serioze e sfidave me të cilat ballafaqohet UEJL, mbetet i përkushtuar ndaj vizionit themeltar të Maks van der Shtulit (Max van der Stoel), ofrimit të mundësive arsimore në gjuhën shqipe, maqedonase dhe angleze në një nivel të krahasueshëm me universitetet e forta perëndimore. Popullariteti i vazhdueshëm i programeve dhe kurrikulave të UEJL-së tregon se Universiteti vazhdon të plotësojë një pozitë unike në mjedisin e arsimit të lartë të Republikës së Maqedonisë.

2. Të arriturat

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Universiteti i Evropës Juglindore përsëri mori mbështetje financiare nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë, e cila i dha Universitetit 500000 euro. Ky subvencionim bujar i mundëson Universitetit të sigurojë bursa për shumë studentë, të cilët përndryshe mund ta gjejnë pagesën e shkollimit një barrë të rëndë për familjet e tyre. Universiteti është mirënjohës për këtë mbështetje dhe beson se ajo e njeh angazhimin e vendosur të institucionit për të prodhuar të diplomuar të thelluar në mendime, të informuar dhe tolerant ndaj kulturave.

UEJL vazhdon të mbajë lidhje të forta me komunitetet ndërkombëtare dhe diplomatike në Republikën e Maqedonisë dhe gjatë periudhës së këtij raporti Universiteti kishte nderin t'i priste ambasadorët e Bashkimit Evropian, Shteteve të Bashkuara dhe Italisë, si dhe Komisionarin e Lartë për Pakicat Kombëtare të OSBE-së. Përveç kësaj, Prorektori për Marrëdhënie Ndërkombëtare pati mundësinë të takohej zyrtarisht me Ambasadorin e Kinës. Universiteti vazhdon t'i ndjekë mundësitë për bashkëpunim ndërkombëtar si në nivelin institucional (përmes memorandumeve të mirëkuptimit ose bashkëpunimit) dhe individualisht (nëpërmjet shkëmbimeve të studentëve, siç është programi Erasmus).

Universiteti vazhdoi të shërbejë si një lokacion për kontributin dhe debatin rajonal, duke organizuar konferenca të shumta akademike gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. Ndër temat që u diskutuan në këto konferenca ishin 'Biznesi dhe edukimi në shekullin e 21-të,' 'Sfidat dhe perspektivat në qeverisjen e sektorit publik,' 'Bashkimi Evropian dhe Krizat e Refugjatëve' dhe 'Multikulturalizmi dhe Gjuha e Kontaktit.' Shtrirja e këtyre temave ilustron shumëllojshmërinë e fushave të hulumtimit të UEJL-së dhe diskutimi i tyre i lejon studentët dhe stafin e UEJL-së të shkëmbejnë ide me mysafirë të shquar nga academia ndërkombëtare dhe rajonale.

Në shkurt të vitit 2018, UEJL nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Universitetin 'Hasan Prishtina' në Kosovë. Ceremonia e nënshkrimit, ishte e planifikuar për të përkuar me 10-të vjetorin e Pavarësisë së Kosovës, ku morën pjesë rektorët e të dy universiteteve dhe ky memorandum synon të nxis bashkëpunimin dhe shkëmbimin e mobilitetit midis këtyre dy institucioneve rajonale të rëndësishme.

Më 8 qershor 2018, Bordi i Universitetit të Evropës Juglindore e emëroi Akad. Prof. Dr. Abdylmenaf Bexheti për të shërbyer si rektor i tretë i Universitetit. Rektori Bexheti zyrtarisht u ngarkua me përgjegjësitë e tij të reja më 12 shtator 2018.

3. Struktura: fakultetet dhe qendrat

Universiteti i Evropës Juglindore operon me dy kampuse universitare në Tetovë dhe në Shkup. Struktura e universitetit përbëhet nga pesë fakultetet:

- ★ Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë;
- ★ Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore;
- ★ Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore;
- ★ Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit;

★ Fakulteti i Drejtësisë.

Duhet të theksohet se Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore është rikonfiguruar dhe e ka përsëritur fokusin e fakultetit të njohur më parë si Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike. Të gjithë studentët e UEJL-së ndjekin lëndët e gjuhëve (që ofrohet nga Qendra e gjuhëve), shkathtësitë e TI (ofrohen nga Qendra për eLearning) dhe lëndët 'zgjedhore të lira' (ofrohen për të gjitha disiplinat). Me këto përjashtime, studentët studiojnë tërësisht në kuadër të fakulteteve të tyre. Hulumtimi realizohet nga studentët dhe stafi në mënyrë individuale dhe bashkëpunuese, me ndihmën e përgjithshme të Zyrës së Hulumtimit dhe dy instituteve hulumtuese të Universitetit: Institutit hulumtues Max van der Stoel dhe Institutit të mjedisit jetësor dhe shëndetësisë.

3.1. Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë është fakulteti më i madh në Universitet, si për nga numri i studentëve të regjistruar ashtu edhe për numrin e stafit. Ofron studime në të tre ciklet, me katër programe në ciklin e parë, shtatë programe në ciklin e dytë dhe dy programe studimore në ciklin e tretë. Përveç kësaj, ekzistojnë dy programe studimore të specializuara të ciklit të dytë që janë organizuar në bashkëpunim me komunitetin lokal të biznesit.

Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë vazhdon të bashkëpunojë me institucionet shkencore, komunitetin e biznesit dhe institucionet publike dhe private në vend dhe më gjerë. Brenda kësaj kornize FBE (në bashkëpunim me Akademinë e Biznesit), ka organizuar dy tryeza të rrumbullakëta me përfaqësues të biznesit dhe stafin akademik të fakultetit. Përveç kësaj, në maj të vitit 2018, Fakulteti organizoi konferencën e dytë shkencore të titulluar "Edukimi i biznesit në shekullin 21", i cili tërhoqi pjesëmarrës nga Maqedonia, Shqipëria, Kosova, Gjeorgjia, Ukraina dhe vendet e tjera evropiane. Në këtë konferencë fakulteti pati nderin të ketë folësin kryesor Dr. P. Sergius Kokun nga Universiteti Atlantik i Floridës, t'u drejtohet pjesëmarrësve.

Fakulteti është fokusuar në ndërtimin e marrëdhënieve me komunitetin dhe në periudhën e mbuluar nga ky raport ka organizuar tre ligjërata të hapura me maturantë të shkollave të mesme në mjediset e fakultetit; ka organizuar takime me prindërit e studentëve të vitit të parë; dhe organizoi një kamp veror me 120 maturantë të shkollave të mesme nga vendi dhe aktivitete të tjera. Stafi akademik i FBE-së është aktiv në projekte të ndryshme hulumtuese dhe sesione trajnuese të organizuara brenda dhe jashtë dhe të gjithë anëtarët e stafit akademik marrin pjesë në konferenca ndërkombëtare dhe kanë botuar punime shkencore, ose libra universitarë në fushën e tyre të hulumtimit. Së fundi, Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë vazhdon të mbështesë iniciativat e mobilitetit të stafit dhe studentëve dhe në periudhën e këtij raporti ka pasur 4 profesorë dhe 12 studentë që morën pjesë në programin Erasmus +.

3.2. Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore

Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore ofron mësim në të tre ciklet e studimit me fokus kryesor në fushën e shkencave kompjuterike, teknologjisë, të dhënave dhe elektronikës. Në vazhdim të tendencave të fundit, Fakulteti i SHTB e ka ruajtur një shkallë më të lartë të punësimit

të të diplomuarve, me 76.30% të punësuar nga të dhënat e Anketës--*SEEU Alumni Destination Survey 2017*.

Jashtë klasave dhe laboratorëve, fokusi kryesor i Fakultetit të SHTB-së në periudhën e këtij raporti ka qenë 1) ndërtimi i marrëdhënieve më të forta me komunitetin lokal dhe ndërkombëtar të biznesit dhe sipërmarrësve, dhe 2) rritjen e profilit ndërkombëtar të programeve SHTB, mësimdhënësve, studentëve dhe aluminit. Në mbështetje të këtyre synimeve, SHTB ka bashkëpunuar me TechPark-un e UEJL-së për të siguruar mundësi për punë praktike për studentët tanë dhe ka pasur 15 anëtarë të stafit që kanë marrë pjesë në konferenca ndërkombëtare në fushat e tyre të specializimit të hulumtimit. Dy anëtarë të stafit të SHTB morën pjesë në Programin e Zhvillimit të Stafit të Universitetit Kiel. Fakulteti vazhdon të mbështesë stafin për të shkruar propozime hulumtuese me qëllimin kryesor të gjetjes së fondeve të jashtme, si dhe rritjen e dukshmërisë së fakultetit, si në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Së fundi, SHTB ka përfunduar dy projekte të mëdha hulumtuese dhe vazhdon të shërbejë si një udhëheqës në administrim projekti si "Fëmijët me dëmtime në të pamurit", i cili sponsorizohet nga Fondacioni Ndërkombëtar i Lions Club dhe USAID.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, ka pasur gjithsej 13 studentë të cilët kanë marrë pjesë në programin Erasmus +. Universitetet e përfshira në këtë shkëmbim kanë qenë Linnaeus në Suedi, NTNU në Norvegji, Universiteti i Bambergut në Gjermani, Universiteti i Vistula në Poloni, Universiteti i Varnës në Bullgari dhe Universiteti i Lihtenshtajnit në Lihtenshtajnit.

3.3. Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore

Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore është koncepti i ri i asaj që më parë ishte Fakulteti i Administratës Publike dhe Shkencave Politike. Gjatë vitit akademik 2017/2018, Fakulteti i APSHP u përball me një numër të paprecedentë të ulët të regjistrimit të studentëve në ciklin e parë dhe të dytë. Për t'iu përgjigjur situatës, Fakulteti ndërmori një kombinim të veprimeve dhe ndërhyrjeve, të vendosura në një proces gjithëpërfshirës të konsultimit që përfshin stafin, studentët e tanishëm dhe aktorët relevantë të komunitetit. Përveç krijimit dhe akreditimit të programeve të reja, Fakulteti i APSHP-së u riemërua me identitetin e ri si Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore.

I sapo konceptuar, Fakulteti i SHSHB-së është fokusuar në rritjen e ofertës akademike të programeve të ciklit të parë dhe të dytë sipas nevojave dhe tendencave të tregut të punës. Kështu, Fakulteti ka akredituar dy programe (Menaxhimi Publik dhe Politikat Publike; Shkenca Politike dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare), të cilët janë funksionale që nga fillimi i vitit akademik 2018-2019. Për më tepër, Fakulteti u përpoq të promovojë këto programe përmes vizitave në shkollat e mesme në Maqedoni, Kosovë dhe Luginën e Preshevës, një përpjekje e ndërmarrë në bashkëpunim me krijimin paralel të një platforme të rrjetëzimit për lidhjen e Fakultetit me alumnin tonë të diplomuar. Fakulteti i SHSHB-së ka ndjekur edhe forma të tjera të bashkëpunimit me shkollat e mesme, posaçërisht trajnimi për mësuesit dhe studentët.

Përveç këtyre aktiviteteve promovuese dhe të rekrutimit, Fakulteti i SHSHB-së ka organizuar dy konferenca të suksesshme shkencore në periudhën e mbuluar nga ky raport. Konferenca e parë,

e titulluar "Qeverisja në Sektorin Publik" u realizua në maj të vitit 2018 dhe konferenca e dytë, "Fillimi i pluralizmit politik në Maqedoni", u planifikua gjatë pranverës dhe verës dhe u realizua në tetor 2018.

3.4. Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit

Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit është i ndarë në katër departamente përbërëse, duke ofruar mësim në fushat e gjuhësisë, pedagogjisë dhe disiplinave të shumta të komunikimit: Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe; Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Angleze; Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane; dhe Departamenti i Komunikimit Ndërkombëtar. Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe ofron mësim pasuniversitar në ciklin e dytë dhe të tretë, ndërsa departamentet tjera ofrojnë mësim në të tre ciklet.

Gjatë periudhës së këtij raporti, Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit vazhdoi të ketë numrin më të madh të pjesëmarrësve në programin e mobilitetit Erasmus + në Universitet. Në këtë periudhë 19 studentë të FGJKK-së e kaluan të paktën nga një semestër në një nga universitetet pjesëmarrëse, si në vijim: Universiteti i Edukimit, Heidelberg; Universiteti i Grazit; Universiteti i Klagenfurtit; ICES La Vendee; Universiteti i Lubjanës; Universiteti i Kalabrisë; dhe Universiteti Dalarna. Përveç kësaj, tre studentë Erasmus nga jashtë kanë ndjekur mësimin në FGJKK për një semestër, dy nga Franca dhe një nga Gjermania. Së fundi, katër studentë të tjerë të FGJKK nga Departamenti i Gjuhës Gjermane kanë kaluar një muaj në Universitetet e Zugut dhe Lucernit.

Fakulteti gjithashtu mbajti bashkëpunimin e tij të vazhdueshëm me Universitetin e Zugut në drejtim të punëtorive të autonomisë së studentëve. Punëtorja e fundit u mbajt në shkurt 2018, në UEJL dhe punëtorja e ardhme do të mbahet në fund të vitit 2018, në Zug. Departamenti i anglishtes gjithashtu ofroi trajnime për mësuesit në Luginën e Preshevës në dhjetor 2017 dhe organizoi një seminar për trajnimin e mësuesve në metodologjinë pedagogjike në pranverë të vitit 2018. Departamenti i gjuhës angleze kishte nderin gjithashtu që të mirëpresë ligjëruesin vizitues—dijetarin e shquar, Prof. Majid Magamis, nga Universiteti Teknik i Tafilës, Jordani. Së fundmi, të gjitha departamentet morën pjesë shtesë në rishikimin e kurrikulës dhe proceset e riakreditimit.

3.5. Fakulteti i Drejtësisë

Fakulteti i Drejtësisë ofron studime në dy fusha kryesore në studimet deridiplomike - Studime të drejtësisë dhe Kriminalistikë dhe siguri, ndërsa ka ofertë më të zgjeruar në ciklet pasuniversitare duke përfshirë ndër të tjera: të Drejtën civile, të Drejtën penale, të Drejtën ndërkombëtare, Krimin kibernetik, dhe të Drejtën kushtetuese dhe administrative.

Në periudhën e mbuluar nga ky raport, Fakulteti i Drejtësisë ka ndjekur iniciativë të shumta, ndër më të rëndësishmet prej të cilave ishin: prezantimi për herë të parë i përgatitjes për provimin e avokaturës (*BAR exam*), për studentët e magjistraturës dhe avokatë të tjerë të diplomuar; vizita e një eksperti udhëheqës nga Komisioni i BE-së, Reinhard Priebe, i cili ligjëroi një lëndë për të drejtat e njeriut për studentët e magjistraturës; organizimi i një konference ndërkombëtare në temën "Korrupsioni në Arsimin e Lartë" (në bashkëpunim me Institutin për Hulumtime dhe

Arsimim Strategjik dhe me Ambasadën Amerikane në Shkup); organizimi i konferencës së dytë vjetore rajonale për studentët e fakulteteve të drejtësisë; pjesëmarrja e suksesshme e studentëve të drejtësisë në konkursin për gjykatë simuluese të mbajtur në Universitetin "Goce Dellçev" në Shtip; organizimi i një tryeze të rrumbullakët me temë: "Marrëdhëniet e punës, problemet aktuale dhe kuadri ligjor për zgjidhjet e tyre, me theks të veçantë në diskriminimin në punë"; dhe organizimin e sesioneve trajnuese për studentët me temën "Barazia në Gjyqësi, Siguria në Jetë" (në bashkëpunim me CLRA-Qendrën për Hulumtime dhe Analiza Ligjore).

Zhvillime të tjera të rëndësishme për Fakultetin e Drejtësisë përfshinin përpjekjet e Fakultetit për ta zgjeruar rëndësinë e tij ndërkombëtare, sidomos nëpërmjet vizitës së dy prokurorëve publikë amerikanë dhe leksioneve të tyre mbi terrorizmin dhe krimet e urrejtjes; vizitat e ambasadorit të BE, Samuel Zhbogar dhe ambasadorit italian Carlo Romeo; dhe profesorët vizitues Jan Muss dhe Daria Lebedeva. Përveç kësaj, katër studentë nga Fakulteti i Drejtësisë morën pjesë në programin Erasmus + në Universitetet e Bolonjës dhe Deusto, ndërsa 2 studentë të tjerë nga Franca ndoqën një semestër në UEJL. Anëtarët e stafit akademik ishin angazhuar aktivisht në paraqitjen e hulumtimeve të tyre në konferenca dhe revista ndërkombëtare dhe dy anëtarë të stafit akademik mbrojtën me sukses disertacionin e doktoraturës.

3.6. Qendra e Gjuhëve

Qendra e Gjuhëve në UEJL ofron mësimin e gjuhëve për të gjithë studentët në studimet derdiplomike në nivel të Universitetit, me përjashtim të atyre që specializohen në disiplina gjuhësore në FGJKK. Rrjedhimisht, shërben pothuajse për të gjithë trupin studentor dhe kontribuon ndjeshëm në mbështetjen institucionale të modelit shumëgjuhësor të arsimit dhe komunitetit të Universitetit.

Në periudhën e mbuluar nga ky shqyrtim, disa nga zhvillimet kryesore të Qendrës së Gjuhëve ishin të lidhura me përfshirjen e shkathtësive profesionale në programet anglisht e avancuar dhe anglisht akademike e avancuar. Syllabuset për këto lëndë janë modifikuar për të përfshirë më shumë komponentë profesionale dhe përdorim të specializuar të gjuhës. Anglishtja për qëllime specifike (ESP) u nda, për të akomoduar ESP-në e specializuar për programe studimi të ndryshme. Stafi i Qendrës së Gjuhëve gjithashtu krijoi katër teste të reja për njohjen e gjuhës, me ndihmën e përfaqësuesit vizitues nga programi Fulbright në QGJ, Ellie Dawson, e cila gjithashtu ishte kontribuuese në krijimin e dy klubeve të shkrimit në QGJ.

Përveç kësaj, stafi i Qendrës së Gjuhëve mbajti një angazhim të lartë për nismat promovionale të Universitetit. Ndër më të rëndësishmet nga këto ishin vazhdimi, për pesë vjet të tjera, të kontratës për mësimin e gjuhës që ofrohet nga stafi i QGJ për stafin e Ambasadës së Shteteve të Bashkuara, në Shkup; kurse gjuhësore shtesë për bizneset dhe nxënësit jo-tradicionale nga rrethina e Tetovës; organizimi i Panairit të Gjuhëve për të kontribuar në promovimin e Ditës së Hapur, pjesëmarrja e gjerë e stafit të LC në vizitat e rekrutimit të nxënësve të shkollave të mesme; festimi i javës së gjuhës italiane në kampusin e Shkupit; mbajtja e kampit amerikan në kampusin e Shkupit për studentët që studiojnë gjuhën angleze; dhe garat nacionale *Spelling Bee* në prill 2018, të organizuara në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Ohrit dhe Korpusin e Paqes.

3.7. Qendra E-Learning

Qendra për E-Learning filloi të funksionojë që nga hapja e Universitetit nga shtatori i vitit 2001, për të ndihmuar bashkësinë e universitetit, si studentët ashtu edhe mësimit, duke shfrytëzuar potencialin e teknologjisë për të përmirësuar mësimit dhe mësuesin. Qendra ofron kushte të shkëlqyera për inkorporimin e E-Learning për të mbështetur studimet e studentëve dhe hulumtimin e stafit. Qendra E-Learning ofron qasje në katër laboratorë kompjuterikë, me mbi 80 kompjuterë modern dhe një laborator multimedial të pajisur me teknologjitë më të fundit. Përveç kësaj, Qendra u ofron studentëve lëndë të lira zgjedhore në softuerin e zyrës së Microsoft (Word, Excel, PowerPoint dhe më shumë).

Qendra gjithashtu ndihmon komunitetin e Universitetit në shfrytëzimin e potencialit të teknologjisë për të përmirësuar mësimit dhe të mësuarit. Qendra siguron mbështetje për zhvillimin e materialeve interaktive dhe plotësuese online për kurset tradicionale dhe organizon punëtorë trajnimi në lidhje me zhvillimin dhe shpërndarjen e materialeve online. Kështu, gjatë periudhës së këtij rishikimi, Qendra filloi përdorimin e *Google Classroom* dhe ka mbështetur stafin dhe studentët në përdorimin e kësaj platforme të re. *Google Classroom* lejon mësimit të krijojnë orë mësimore, dizajnojnë detyra, të komunikojnë me studentët, organizojnë dosjet, shikojnë punën e studentëve online dhe në mënyrë të vazhdueshme.

Misioni i Qendrës E-Learning është i dyfishtë: siguron trajnim dhe ndihmë për stafin e Universitetit dhe studentët dhe ofron mbështetje dhe qasje në teknologji dhe platforma të përditësuara të mësimit.

4. Sigurimi i cilësisë

Zyra për Sigurimin e Cilësisë (ZSC) e Universitetit ka vazhduar të luajë rolin e saj të rëndësishëm për të siguruar që mësimit, të mësuarit dhe shërbime të tjera për studentët, stafin dhe komunitetin realizohen në një standard të lartë të përsosmërisë. ZSC e Universitetit ka ndër marrë aktivitetet të ndryshme nga tri fusha kryesore për të arritur këtë objektiv.

Në lidhje me përmirësimin e të mësuarit dhe mësimit, ka implementuar me sukses skemën e re të vëzhgimit nga kolegët me fokus të zgjeruar në përmbajtjen, vlerësimin dhe përdorimin efektiv të mjeteve digjitale. Vlerësimi online nga studentët u pilotua dhe rezultoi me një normë të lartë të përgjigjes së studentëve në semestrin e parë, si dhe identifikimin e fushave për përmirësim në të ardhmen. Në lidhje me strukturat dhe shërbimet e tjera të Universitetit, të dhënat e marra përmes këtyre proceseve janë marrë në konsideratë për të zhvilluar një profil efektiv të performancës efektive dhe motivuese të stafit, lidhur me vlerësimin dhe promovimin e stafit. Zyra vazhdoi të ofrojë trajnime të përshtatshme të përgjithshme dhe individuale për vëzhguesit e rinj dhe stafin e ri. Gjithashtu ka kontribuar në krijimin e bashkëpunimit më të ngushtë me komunitetin, duke prodhuar të diplomuar të përshtatur për nevojat e tregut të punës, veçanërisht nëpërmjet monitorimit të zbatimit të skemës së re të punës praktike. Në mënyrë të ngjashme, programi i ri i tutorimit ka ofruar një qasje më të personalizuar për mësimit dhe mësuesin dhe mbështetje të fuqishme për studentët e sapo regjistruar.

Nga këndvështrimi i menaxhimit të cilësisë - planifikimit strategjik, strukturave dhe përdorimit të provave, Zyra e SC ka vazhduar të mbështesë aktivitetet e bordeve për bashkëpunim dhe

mirëbesim me komunitetin (Ekipet e Cilësisë së Fakulteteve). Njëri nga elementët kryesor të kësaj ka qenë përqendrimi në kompetencat profesionale dhe zhvillimin e karrierës. Zhvillimi i sistemit të dyfishtë të auditimit për vlerësimin e performancës është mbajtur në mënyrë aktive përmes aktiviteteve të ndryshme. Një plan veprim i detajuar për zbatimin e rekomandimeve nga Programi i Vlerësimit Institucional (IEP) është përpiluar pas realizimit të dy vizitave në terren si pjesë e projektit "Projekti për Zhvillimin e Shkathtësive dhe Përkrahjes së Inovacionit" (SDISP), zbatuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë përmes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Zyra e SC ka organizuar trajnime efektive dhe efikase të stafit të zhvillimit profesional në bazë të nevojave të identifikuara për të motivuar dhe tërhequr stafin më të kualifikuar dhe për të ruajtur kulturën tashmë të avancuar institucionale të cilësisë.

5. Mësimdhënia dhe të mësuarit


5.1. Programet dhe statusi

Gjatë periudhës së këtij rishikimi, UEJL ka ofruar studime të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në të gjithë pesë fakultetet. Në programet magjistraturës dhe doktoratës ndiqen leksionet në klasë dhe më vonë bëhet hulumtimi dhe përpilimi i tezës për të cilën organizohet mbrojtje formale publike. Të gjitha tezat e magjistraturës dhe doktoratës së UEJL-së janë mentoruar nga mentorë të akredituar nga Ministria e Arsimit të Republikës së Maqedonisë dhe janë pothuajse gjithmonë stafi i UEJL-së.

Të dhënat në vazhdim përshkruajnë ciklin e jetës studentore nga regjistrimi deri në diplomim.


5.2. Regjistrimi i studentëve

Tabela 1, paraqet të dhënat Totale të regjistrimit për vitet akademike 2015-2016-2017-2018. Siç shihet, regjistrimet u ulën në mes të viteve akademike 2015-2016 dhe 2016-2017, megjithëse në vitin akademik 2017-2018 kishte një regjistrim pak më të lartë se në vitin akademik 2016-2017. Lulahatjet e përgjithshme janë në përputhje me regjistrimin e rreth 1000 studentëve në çdo vit akademik, me devijime pozitive rreth 20-100. Këto shifra ndryshojnë pak nga raportet e mëparshme për shkak të metodës së re të përdorur këtu për grumbullimin e të dhënave dhe kohën pak më të ndryshme të afatit kur regjistrimi është matur për këtë raport.



Grafikoni 1. Numri i përgjithshëm sipas viteve akademike


Grafikoni 1, paraqet numrin e regjistrimeve sipas gjuhës së studimeve. Të dhënat paraqesin disa tendenca të qarta. Studimi në gjuhën shqipe vazhdon të jetë në mënyrë të konsiderueshme oferta akademike më e popullarizuar e Universitetit. Ofertat në gjuhën angleze mbeten në vend të dytë, ku përfaqësojnë një nga pesë studentët e UEJL-së zgjedh të ndjek një lëndë që ofrohet në gjuhën angleze. Me kënaqësi mund të konstatojmë se ofertat në gjuhën maqedonase tregojnë një kthim të lehtë në rritjen e numrit të regjistrimeve, si në përqindje ashtu edhe në numra të përgjithshëm. Afërsisht dyfishi i numrit të studentëve kanë zgjedhë ofertat në gjuhën maqedonase në 2017-2018 sesa që janë regjistruar në vitin 2016-2017.



GRAF 2. Numri i përgjithshëm i regjistrimeve

Grafikoni 3 raporton regjistrimet e përgjithshme sipas fakulteteve për tre vitet e fundit. Siç mund të shihet, fakultetet mbesin përgjithësisht të qëndrueshëm në vitin 2017-2018 krahasuar me

regjistrimet e viteve të mëparshme, por tek Fakulteti i Drejtësisë vërehet një rënie prej pothuajse 30, B&E duke parë një rritje prej 20 dhe fakulteti i riformuluar i APSHP/SHSHB gati 50.




GRAFI 3. Numri i përgjithshëm i regjistrimeve sipas fakulteteve

5.3. Kalueshmëria e studentëve

Kalueshmëria e studentëve dhe diplomimi janë treguesit kryesorë të suksesit, ose dështimit institucional. Megjithatë një përqindje e vogël e studentëve mund të tërhiqen për shkaqe të ndryshme (dështimi akademik, presionet familjare, sëmundjet, vështirësitë financiare), përgjithësisht konsiderohet një dobësi institucionale për të pasur përqindje të larta të tërheqjes, ose dështimeve të tjera për t'u diplomuar.

Grafikoni 4 paraqet të dhënat që lidhen me diplomimin në kohë. Këto të dhëna janë aktuale dhe flasin për gjendjen deri më 10 nëntor 2018. Diplomimi në kohë përcaktohet si përqindja e studentëve që përfundojnë studimet e tyre në periudhën trevjeçare të synuara nga kurrikula akademike. Të dhënat tregojnë se shkalla më e lartë e diplomimit në kohë për gjeneratën më të fundit të diplomuar (2015-2016) është arritur nga Fakulteti i Administratës Publike dhe Shkencave Politike; shkalla më e ulët e diplomimit në kohë për atë gjeneratë është arritur nga Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë. Universiteti në mënyrë të qartë vazhdon të shoh mospërputhje të madhe midis regjistrimeve dhe diplomimit në kohë.



GRAFIKONI 4. KALUESHMËRIA DHE DIPLOMIMI NË KOHË SIPAS FAKULTETEVE

5.4. Qendra e karrierës dhe punësueshmëria

Qendra e karrierës e UEJL-së është njësi kryesore e Universitetit që ndihmon hyrjen e studentëve në tregun e punës. Si e tillë, QK mbikëqyr përmbushjen e praktikave të kërkuara të studentëve, dhe përpiqet të krijojë marrëdhënie me komunitetin për të lehtësuar mundësitë shtesë për punë praktike. Qendra gjithashtu organizon panairin vjetor të karrierës, në të cilin kompanitë vendore dhe kombëtare dhe OJQ-të rekrutojnë studentët aktualë dhe ish studentët të UEJL-së. Përveç kësaj, Qendra e karrierës ofron asistencë për shkathhtësitë e punës (shkrimin e CV, udhëzime, praktika, intervistë pune, etj.), dhe shpërndan njoftimet për vendet e lira të punës. Përfundimisht, Qendra e karrierës gjithashtu zhvillon anketat për punësimin me të posa diplomuarit, për të vlerësuar mundësitë e punësimit dhe vështirësitë e të diplomuarve të UEJL-së (dhe nga të cilat anketa rrjedhin shumica e të dhënave në këtë raport).

Të dhënat tregojnë se shkalla e përgjithshme e punësimit të të diplomuarve për vitin 2016 (grupi më i fundit i të diplomuarve të anketuar) është 51%, por, 7% e tyre raportohen si të papunë sipas zgjedhjes (zakonisht për arsye familjare) dhe 12% të tjerë vazhdojnë studimet e tyre në UEJL, ose në ndonjë universitet tjetër. Kështu vlerësohet se shkalla e papunësisë reale e të diplomuarve ka të ngjarë të jetë 30%, prej të cilëve 21% e raportojnë veten si të papunë dhe 9% raportojnë se i vazhdojnë studimet e tyre për shkak të papunësisë.

Kur konsiderohet në aspekt individual sipas fakulteteve, shkalla më e lartë e papunësisë së të diplomuarve është nga Fakulteti i Drejtësisë, me 49% të papunësisë. Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike (tash SHSHB) ka shkallën e dytë më të lartë të papunësisë në mesin e të diplomuarveme 47%. Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit ka shkallë të papunësisë prej 34%, kurse Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë raporton një shkallë papunësie prej 33%. Shkalla më e ulët e papunësisë vërtetohet nga Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore, i cili regjistron një normë papunësie prej 24%.

Kur vlerësohet në nivel individual, të diplomuarit meshkuj raportojnë një shkallë më të ulët të papunësisë (32.20%), sesa femrat e diplomuara (44.70%). Ka një ndryshim të dukshëm në mesin e

etnive: të diplomuarit e përkatësisë etnike shqiptare raportojnë një normë papunësie prej 39.70%; të diplomuarit e përkatësisë etnike maqedonase raportojnë një normë papunësie prej 29.10%; dhe të diplomuarit e etnive të tjera raportojnë një shkallë papunësie prej 100% (e cila konsiderohet si një anomali statistikore bazuar në numrin e ulët të përgjigjeve nga ky grup).

Anketa e punësimit ofron indikacione të paqarta në lidhje midis suksesit akademik dhe punësimit. Në mesin e të anketuarve, ata të diplomuar me notë mesatare nga 6-7 kishin një shkallë punësimi prej 62.70%; ata të diplomuar me notë mesatare nga 7-8 kishin një shkallë punësimi prej 59.60%; ata të diplomuar me notë mesatare nga 8-9 kishin një shkallë punësimi prej 53.80%; ndërsa ata të diplomuar me notë mesatare nga 9-10 kishin një shkallë punësimi prej 71.10%. Kështu grupi që ka më shumë gjasa të punësohen ishin ata me nivelin më të lartë të suksesit akademik; në mënyrë shqetësuese, grupi i dytë me shumë gjasa për t'u punësuar ishte ai me notë mesatare nga 6-7. Kjo sugjeron që duhet bërë më shumë punë për të lidhur ndërtimin e shkathtësive dhe vlerësimin e studentëve me nevojat e tregut praktik të punës.

Duhet të theksohet se të gjitha këto të dhëna rrjedhin nga vetë-raportimi nga ata të diplomuar që zgjedhën të përgjigjen në sondazhet e Qendrës së karrierës dhe nuk mund të verifikohen në mënyrë të pavarur për saktësinë pa shkelur privatësinë dhe konfidencialitetin e diplomuarve .

5.5. Asociacioni Alumni

Asociacioni Alumni i UEJL-së është definuar në Statutin e Universitetit, por nuk ekziston në kuptimin funksional. Kjo paraqet një *mundësi* të konsiderueshme të humbur për Universitetin dhe për vet alumnin. Përfitimet e asociacionit aktiv të aluminit janë të konsiderueshme. Si të diplomuar të suksesshëm, alumni përfaqëson ambasadorët më efektivë të institucionit. Aktualisht, shtrirja e Alumni është kryesisht e kufizuar në nismat e Fakultetit dhe në kontaktet profesionale të Qendrës së Karrierës.

Duhet të jetë një nga prioritetet kryesore të Universitetit për të iniciuar dhe mbështetur rithemelimin e asociacionit funksional Alumni dhe për të harmonizuar prioritetet asociacionit të rithemeluar Alumni me nevojat dhe planifikimin strategjik të Universitetit.

6. Hulumtimi

Hulumtimi është një nga angazhimet kryesore institucionale të Universitetit të Evropës Juglindore. Në rangimin e fundit sipas Shanghai Jiao Tong, Universiteti i Evropës Juglindore u rendit i dyti në Republikën e Maqedonisë për hulumtim shkencor. Hulumtimi është i rrënjosur në fusha të shumta të Universitetit. Studentët, në të dy ciklet e studimit, në magjistraturë dhe doktoraturë, duhet të kryejnë dhe publikisht të mbrojnë hulumtimet origjinale për të marrë diplomat e tyre. Përveç kësaj, stafi akademik kërkohet, që të kontribuojë në hulumtimin në fushat e tyre të specializimit, siç dëshmohet nga prezantimi publik në konferenca, ose në botimet në revista të rishikuara nga kolegët, si kusht i avancimit profesional.

Zyra për hulumtim është zyra kryesore për koordinimin dhe mbështetjen e hulumtimit të Universitetit. Përmbush funksione të shumta në mbështetje të hulumtimit në UEJL: rekomandon dhe publikon mundësitë për konferenca dhe thirrjet me reputacion për punimet; heton dhe paralajmëron në lidhje me konferencat e diskutueshme dhe revistat e dyshimta; koordinon

punën promovuese të Komitetit Qendror të Hulumtimit; siguron trajnime për tema të lidhura me hulumtimet; koordinon rimbursimin e buxhetit të hulumtimit; si dhe organizon dhe publikon *SEEU Review*.

UEJL e ka atë që ka të ngjarë të jetë mbështetja më e barabartë dhe më bujare që ndahet për hulumtimin në një universitet ballkanik. Të gjithë anëtarët e stafit akademik me orar të plotë të UEJL-së kanë të drejtë deri në 700 euro për mbështetje hulumtuese. Ky financim mund të përdoret për të mbuluar kostot e pjesëmarrjes në konferencë, përkthimit, ose ndihmës redaksionale, ose kostove të tjera hulumtuese. Gjatë periudhës së mbuluar nga ky rishikim, Zyra e hulumtimit (nën *udhëheqjen* e Provostit) miratoi 51,196 euro në mbështetje të hulumtimit, të shpërndara si më poshtë: Fakulteti i Biznesit dhe Ekonomisë —12,700 euro; Fakulteti i Shkencave dhe Teknologjive Bashkëkohore —8224 euro; Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore — 8692 euro; Fakulteti i Gjuhëve, Kulturave dhe Komunikimit — 5055 euro; Qendra e Gjuhëve — 10,500 euro; dhe Fakulteti i Drejtësisë —6025 euro. Këto shuma mundësuan që stafi akademik të mbajnë kërkesat e tyre hulumtuese, siç specifikohet në Rregulloren për promovimin në thirrje mësimore-shkencore; gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, asnjë anëtar i stafit akademik nuk është penguar të avancojë në thirrje profesionale nga dështimi për të prodhuar hulumtime të mjaftueshme.

Zyra e hulumtimit, gjithashtu ka publikuar *SEEU Review* nën siglën e DeGruyter, shtëpi botuese prijatare me qasje të hapur për materialet shkencore, revistë dyfish e recensuar nga kolegët në mënyrë dhe as nuk pranon as nuk kërkon ndonjë pagesë për ndonjë shërbim, rishikim apo publikim. Publikimi në *SEEU Review* bazohet tërësisht në bazë të meritës dhe nuk i kushton asgjë kontribuuesve.

Në vitin akademik 2017-2018, Universiteti i Evropës Juglindore organizoi konferenca të shumta, siç u përmend më lart, me ndihmën e Zyrës së Hulumtimit dhe Instituti Hulumtues "Max van der Stoel", Komiteti Qendror i Hulumtimit gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, u takua nëntë herë, gjatë së cilës ata ndanë pikë për dosjet e hulumtimit të 29 anëtarëve të stafit që aplikojnë për promovim në thirrje, si dhe formuluan dhe miratuan një rishikim të Strategjisë së Hulumtimit të UEJL-së.

6.1. Instituti hulumtues "Max Van der Stoel"

Instituti i hulumtues "Max van der Stoel" është njësi kryesore e Universitetit të Evropës Juglindore për organizimin e konferencave dhe kërkime bashkëpunuese në Universitet. MVDSRI mbledh stafin e Universitetit dhe ekspertët e jashtëm në 'grupet hulumtuese', të cilat janë të ngarkuara me kryerjen e hulumtimeve dhe dorëzimin e projekt-propozimeve dhe aplikimeve. Megjithëse Instituti do të ndihmojë çdo fakultet në organizimin dhe promovimin e interesave të konferencës, temat kryesore të adresuara nga MVDSRI janë diplomacia, parandalimi dhe menaxhimi i konflikteve, studimet kulturore dhe shkencat politike.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky rishikim, MVDSRI organizoi konferenca, forume dhe tryeza të rrumbullakëta. Forumi i Institutit "BE, Refugjatët dhe Kufijtë: Si është e rëndësishme Republika e Maqedonisë" paraqiti një fjalim të rëndësishëm nga Gerald Knaus, drejtori i Iniciativës Evropiane të Stabilitetit. Forumi u organizua nga MVDSRI më 7 nëntor 2017 në kampusin e UEJL-së, Shkup.

Përveç kësaj, konferenca ndërkombëtare akademike "Qeverisja në Sektorin Publik: Sfidat dhe Perspektivat" u organizuan bashkërisht nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore Bashkëkohore dhe Instituti Max van der Stoel, 4-5 maj 2018. Përveç kësaj, MVDSRI ka organizuar një sërë forumesh shkencore mbi politikën e jashtme të Republikës së Maqedonisë ndaj fqinjëve të saj, duke u fokusuar veçanërisht në tema të tilla si: marrëdhëniet diplomatike, çështjet e sigurisë, arsimi, tregtia, etj. Kjo, u organizua së bashku me Fondacionin Friedrich Ebert dhe universitete të tjera në Maqedoni, gjatë gjysmës së dytë të vitit 2017. Një simpozium i titulluar "Siguria Rajonale dhe Marrëdhëniet Fqinjësore" u organizua nga MVDSRI dhe Kolegji i Evropës, Natolin, Poloni. Këtë e ndoqën 40 studiues nga e gjithë bota të bashkuar me programet e Kolegjit të Evropës dhe nga studiues nga Maqedonia. Simpoziumi u mbajt më 13 prill 2018, në UEJL, Shkup.

Në vjeshtën 2017 dhe në pranverën e vitit 2018, Instituti Max van der Stoel u përqendrua në mbledhjen e suksesshme të materialeve shkencore të dijetarëve që morën pjesë në konferencën "Multikulturalizmi dhe gjuha e kontaktit" në gusht 2017, organizuar në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, njësia për Gjuhësi Areale. Këto përmbledhje janë botuar në mënyrë elektronike.

Përmes grupeve hulumtuese, MVDSRI vazhdoi të mbështesë idetë për zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese, mbledhjen e ideve dhe inicimin e aplikimeve për projekte për temat aktuale dhe hulumtimet me interes. Ndër temat e këtyre iniciativave ishin 'Qeverisja e Mirë' (ku u organizua një konferencë akademike ndërkombëtare); 'Marrëdhëniet ndër-komunitare dhe dialogu politik' (u organizuan një seri forumesh); 'Të drejtat e njeriut' (organizuan një tryezë të rrumbullakët në dhjetor 2017); 'Multikulturalizmi dhe politikat gjuhësore' (tekste të mbledhura, redaktimi dhe përgatitja e vëllimit të librit mbi multikulturalizmin dhe gjuhën e kontaktit në verë 2018); 'Studime Evropiane' (një forum shkencor me drejtorin e Iniciativës Evropiane të Stabilitetit); 'Diplomacia parandaluese dhe zgjidhja e konfliktit' (e përfshirë në organizimin e simpoziumit me Kolegjin e Evropës, Natolin, prill 2018, për sigurinë rajonale); dhe "Grupi i Kërkimeve të Ballkanit" (mori pjesë aktive dhe përfaqësoi Institutin në secilën prej serive të forumeve të Institutit me Friedrich Ebert Stiftung mbi politikën e jashtme të Maqedonisë ndaj fqinjëve të saj, vjeshtë dhe dimër 2017).

6.2. Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit

Instituti i mjedisit jetësor dhe shëndetit është institut hulumtues i Universitetit të Evropës Juglindore i fokusuar në ndryshimet klimatike, mbrojtjen e përgjegjshme mjedisore, energjinë e pastër dhe reduktimin e gazrave të dëmshme. Është i vendosur në ndërtesën e Energjisë së qëndrueshme në kampusin e Tetovës. Ai mbron hapat që duhet të ndërmerret nga vetë Universiteti, si dhe ndihmon njësitë e tjera (siç është Komuna e Tetovës) për të promovuar politikën dhe veprimet e përgjegjshme mjedisore. Rrjedhimisht IEH ka ndërmarrë iniciativat lokale në kampus, si dhe ka ndihmuar Komunën e Tetovës për të krijuar Planin e vet të Veprimit për Klimën. Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, IEH vazhdoi të hetojë mënyrat në të cilat ndotja e Universitetit dhe gjurmët e karbonit mund të reduktohen, nëpërmjet përdorimit më të madh të peletëve nga biomasa për ngrohje, përdorimit të vazhdueshëm të impiantit fotovoltaiik dhe rritjes së fushatave të ndërgjegjësimit për ruajtjen e burimeve dhe ripërdorimin e produkteve që janë të ripërdorshme.

6.3. Zyra për marrëdhënie ndërkombëtare

Universiteti i Evropës Juglindore u themelua nga bashkëpunimi i agjencive ndërkombëtare dhe kontributeve individuale të shteteve dhe me qëllim mban fokusin, identitetin dhe strukturën akademike ndërkombëtare. Universiteti është krenar për të mirëpritur studentët e rregullt dhe me korrespondencë nga jashtë Republikës së Maqedonisë në trupin studentor dhe mban personelin ndërkombëtar në orar të plotë dhe në bazë të vizitave.

Gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport, Zyra e Marrëdhënieve Ndërkombëtare nënshkroi marrëveshje të reja dypalëshe për bashkëpunimin Erasmus + me këto universitete: Universiteti i Vistula; Universiteti i Grazit; Instituti Leiria në Portugali; Universiteti i Osijekut; Universiteti i Splitit; dhe Universiteti i Beira-Interior, Portugali. Gjashtë studentë të huaj Erasmus + erdhën në UEJL gjatë periudhës së mbuluar nga ky raport. UEJL gjithashtu mbështeti dy të ftuar të stafit nga Programi Fulbright i SHBA. ZMN gjithashtu nënshkroi memorandume të reja, ose të zgjeruara me tre universitete, veçanërisht Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Floridës së Jugut në Shën Petersburg dhe Universitetin e Indianës Jugore.

Duke njohur Republikën e Turqisë si një grup të rëndësishëm të rekrutimit dhe zhvillimit të mundshëm të studentëve, ZMN ka hapur një Qendër të Rekrutimit dhe Promovimit të UEJL-së në Stamboll, me qëllim promovimin e UEJL-së si një destinacion i dëshirueshëm për studentët turq. Kjo u krye kryesisht në mbështetje të programit të mëparshëm në Fakultetin Drejtësisë, i cili u dedikohet konkretisht qytetarëve të Turqisë dhe pjesërisht ofrohet në gjuhën turke. Përveç kësaj, një broshurë e përgjithshme dhe promovuese e Universitetit të Evropës Juglindore u përgatit në gjuhën turke.

Së fundi, ZMN ishte angazhuar në organizimin e një Projekti Ndërkombëtar të Hulumtimit për Sigurinë në Ballkanin Perëndimor me titull "Rivalitetet Rajonale në Ballkanin Perëndimor: 2017-2018". Kjo u ndërmor në bashkëpunim me Universitetin Antwerp dhe Universitetin Kolumbia dhe u mbështet nga Programi Evropian Fondi për Ballkanin, Bruksel. Projekti përfshiu pjesëmarrës (më shumë se 30 profesorë dhe ekspertë) nga Shtetet e Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe rajoni i Ballkanit.

7. Ndërmarrësia dhe zhvillimi

Universiteti i Evropës Juglindore i ka dhënë përparësi ndërtimit dhe thellimit të bashkëpunimit me komunitetin biznesit dhe ndërmarrës të Republikës së Maqedonisë. Universiteti synon të trajtojë dhe mbështesë sipërmarrësit e rinj, si dhe të angazhohet në mënyrë konstruktive me udhëheqësit e bizneseve nga rajoni për mundësitë bashkëpunuese, mundësitë për punë praktike, hartimin e kurrikulave dhe këshillat e tregut të punës. Në përputhje me rrethanat, UEJL ndjek "modelin Triple Helix", veçanërisht: 1) duke lehtësuar një bashkëpunim më të madh formal midis botës akademike dhe asaj të biznesit dhe 2) duke minimizuar boshllëqet e aftësive ndërmjet trajnimit akademik dhe tregut praktik të punës. Për të përmbushur këto kërkesa, Universiteti disa vite më parë themeloi Komitetin për Marrëdhënieve të Biznesit, i cili përbëhet nga përfaqësues të menaxhmentit ekzekutiv të Universitetit, Qendrës së Karrierës dhe dy iniciativa të mëdha sipërmarrëse: Qendra për Zhvillimin e Biznesit (QZHB) dhe Parku Teknologjik i UEJL (TechPark), të

gjitha janë bashkuar në një entitet biznesi të pavarur të quajtur Qendra e Biznesit dhe Inovacionit (*Business & Innovation Center-BIC*).

Qendra e Zhvillimit të Biznesit është përpjekja e Universitetit që të përshtat ekspertizën dhe burimet e bashkësisë akademike të UEJL-së me nevojat praktike të kompanive lokale. Kështu, BDC organizon dhe siguron trajnim biznesi, këshillim biznesi dhe aftësi të tjera profesionale (të tilla, për shembull, si mësim gjuhësor). Përmes QZHB-së, UEJL është një partner i kompanive dhe institucioneve të tjera në aspektin profesional dhe organizativ. Në mënyrë të veçantë, QZHB ndihmon kompanitë në organizimin profesional të konferencave, seminareve dhe takimeve të biznesit, duke shfrytëzuar hapësirat e UEJL –së në kampuset në Tetovë dhe Shkup. Një shërbim shtesë që BDC iu ofron kompanive është promovimi i shërbimeve dhe produkteve të tyre për studentët dhe punonjësit e UEJL-së në forma të ndryshme (email, postera, fletushka). QZHB gjithashtu ndihmon kompanitë në identifikimin e trajnimeve, ose mundësive të tjera të ndërtimit të aftësive, dhe ofrimin e udhëzimeve për të përmbushur këto nevoja. Ndër partnerët vendorë më të shquar dhe më të vlefshëm janë: Dauti Komerc (industria e shitjes me pakicë); Alkaloid (farmaceutike); Sparkasse Bank (bankare); Kipper (industria e shitjes me pakicë); Lycamobile (telefoni mobile); Ecolog (logjistikë); Harbini Cosmetics (industria shëndetësore); dhe Ohridska Banka (banka dhe financa). QZHB gjithashtu ka arritur bashkëpunim të shkëlqyeshëm me disa nga donatorët më të mëdhenj të projekteve në Maqedoni, si Ambasadën Amerikane në Shkup, Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Konfederatën e Biznesit të Maqedonisë, Odën Ekonomike të Maqedonisë Veri-Perëndimore, GIZ, DMWV, etj.

TechPark është i pari dhe deri më tani parku i vetëm i teknologjisë në Maqedoni, i vendosur në kampusin e Tetovës. I themeluar në vitin 2013, TechPark është iniciativa kryesore e Universitetit për të mbështetur konceptimin dhe krijimin e NVM-ve (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), duke krijuar një hapësirë bashkëpunuese për bizneset e reja dhe komunitetin akademik të UEJL-së dhe burimet e kampusit të Tetovës. Misioni i synuar i TechPark është të nxisë aftësitë e biznesit, duke thelluar lidhjet midis sipërmarrësve të rinj (veçanërisht në fushat që lidhen me teknologjinë dhe programimin) dhe akademisë. TechPark është anëtar në gjendje të mirë për 14 organizatat kombëtare dhe 22 ndërkombëtare të drejtuara drejt promovimit të sipërmarrjes dhe zhvillimit fillestar. Ai gjithashtu ofron shërbime të shumta shtesë jashtë, të tilla si: modelimi i ideve, trajnime fillestare, analiza të tregut, mentorim dhe shërbime konsulence, qasje në kapital, shërbime ligjore dhe hapësira shkallëzuara për zyra. Gjithashtu, ka zhvilluar dy shërbime të specializuara që shtojnë vlerë në portofolin e saj: 1) Vlerësimi i Kompanisë dhe 2) Raporti Financiar i Korporatës. Përmes takimeve të shpeshta dhe ngjarjeve gjysmë formale, TechPark promovon kulturën sipërmarrëse dhe tendencat e sipërmarrjes për studentët, NVM-ve vendase dhe operatorët e pavarur. Pjesëmarrësit e TechPark janë angazhuar aktivisht në hekatonet e (*NASA Space Apps Challenge*), programe nxitje (*Start Up Academy*) dhe mundësitë e investimeve që lidhin investitorët vendas dhe ndërkombëtarë dhe talentet fillestar. Që nga perioda e këtij raporti, TechPark i UEJL-së , ka ndihmuar më shumë se 26 kompani, ka hapur 134 vende të reja të teknologjisë në treg, ka ofruar 66 raste të punës praktike për studentët në mesin e kompanive në kampus dhe ka ndërtuar një kulturë në kampus që shpërblen dhe promovon bashkëpunimin midis biznesit , sipërmarrësve të rinj dhe akademisë.

Universiteti riafirmon angazhimin e tij për biznesin dhe ndërveprimin akademik, duke besuar se kjo promovon mundësitë më të mira për të dy aktorët. Bashkëpunime të tilla i mundësojnë UEJL-së: 1) të ndërtojë dhe të mbajë kurrikula të përgjegjshme ndaj tregut; 2) njëkohësisht, për të prodhuar të diplomuar për punë; 3) të ndihmojë në diversifikimin e rrjedhave të të ardhurave të UEJL-së; dhe 4) të përmbushë pozitën udhëheqëse të komunitetit të mandatuar nga misioni themelues i Universitetit.

8. Financimi

Duke qenë institucion i arsimit të lartë privat-publik jo-fitimprurës, financimi i aktiviteteve të mësimdhënies dhe hulumtimit të Universitetit është mbështetur kryesisht nga institucioni, me pak të ardhura nga jashtë institucionit. Në këtë kontekst shumica e të ardhurave rrjedhin nga pagesa e studentëve. Kjo pjesëmarrje e të ardhurave nga pagesa e shkollimit me këtë nivel ka të ngjarë të mbetet në të ardhmen e afërt, duke e bërë atë si burim kryesor të të ardhurave për Universitetin. Burime shtesë të të ardhurave kanë origjinën në aktivitetet e shërbimeve të tjera universitare (duke ofruar trajnime për kompanitë e jashtme, ose hartimin e programeve zhvillimore për bizneset. Një burim tjetër financimi i operacioneve të Universitetit është buxheti i shtetit, i cili për të katërtin vit radhazi ka vazhduar të subvencionojë Universitetin, i cili ka qenë jashtëzakonisht i dobishëm në ruajtjen e ofrimit të arsimit me cilësi të lartë nga UEJL. Interesi nga depozitat bankare afatshkurtra dhe afatgjata, si dhe investimet në fondet e investimeve me rrezik të ulët janë një shtesë tjetër në buxhetin e Universitetit.

Duhet pasur parasysh se toka në të cilën ndodhet kampusi i Tetovës nuk i përket Universitetit apo Fondacionit, por Qeverisë dhe përdoret në bazë të një marrëveshje afatgjate.

Nëse ne kemi një vështrim të afërt në portofolin e të ardhurave për vitin akademik 2017/2018 është si më poshtë: pagesa e shkollimit paraqet 86.18% e të ardhurave, të ardhurat komerciale janë 3.81%, aktivitetet financiare janë 0.90%, projektet 0.31% dhe subvencionet nga shteti janë pjesa e mbetur 8.80%.

Siç mund të shihet, ekziston një mbështetje e madhe në pagesat e shkollimit nga studentët, që do të thotë ekspozim financiar i Universitetit ndaj ndryshimeve demografike, ose mangësive në regjistrimin e studentëve. Është e dëshirueshme të identifikohen dhe të ndiqen burime shtesë të të ardhurave dhe të diversifikohen rrjedhat e të ardhurave.

PJESA E MJETEVE NGA BUXHETI NË TOTALIN E MJETEVE

Sipas të dhënave më të fundit, totali i mjeteve të Universitetit është 1,177,763,000 MKD. Për vitin fiskal 2017, të ardhurat nga pagesa e shkollimit dhe donacionet për bursa ishte 225,738,000 MKD. Të ardhurat totale për atë vit ishin 547,489,000 MKD.

PJESA E MJETEVE NGA PAGESA SHKOLLIMIT NË TOTALIN E MJETEVE

Sipas numrave, pjesëmarrja e pagesave të studentëve në totalin e mjeteve është 19.17%.

9. Mjedi dhe shërbimet në kampus

9.1. Mbështetja studentore

Mbështetja e studentëve kryesisht është realizuar nëpërmjet Shërbimeve studentore dhe Zyrës për ndihmë financiare. Studentët për vitin akademik 2017/2018 janë përkrahur financiarisht nëpërmjet programit të bursave të universitetit, grantet e donatorëve të bursave, programi "Punë dhe studime", si dhe programi financiar-zbritje për studentin e dytë dhe të tretë të familjes (Tabela 1), në gjithsej rreth 25.5% të studentëve të rregullt në studimet deridiplomike financiarisht janë përkrahur në një farë mase.

Bursat jepen në bazë të meritës dhe meritat vlerësohen nga performanca akademike e studentit. Në nivelin universiteti janë dhënë 328 bursa, pra rreth 19% e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt dhe bursat mbulojnë tarifat e pjeshme dhe të plota të programit përkatës të studimit.

Nga pikëpamja financiare, rreth 2.8% e studentëve të rregullt janë përkrahur nëpërmjet programit "Punë dhe studime". Përmes këtij programi, studentët u angazhuan në shërbimet e ndryshme të universitetit, duke përfutur nga përvoja relevante nga edhe realizojnë mjete financiare për të mbuluar një pjesë të tarifës së shkollimit të tyre. Në këtë vit akademik, 49 studentë ishin të angazhuar në këtë program.

Gjithashtu, në mbështetje të familjeve që kanë më shumë se një student që studion në UEJL është bërë zbritje e pagesës së shkollimit për studentin e dytë ose të tretë nga e njëjta familje. Nëpërmjet këtij programi të Universitetit janë mbështetur 65 studentë, çka përfaqëson 3.8% të numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt.

Vëmendje e veçantë i është dhënë zhvillimit të qasjes efektive për studentët me nevojë të veçanta dhe mundësitë për bursa për këtë grup të studentëve.

UEJL në bashkëpunim me komunitetin e biznesit ka dhënë 16 bursa që mbulojnë 100% të pagesave të shkollimit në programe të ndryshme. Kjo është dëshmuar si një shtesë e vlefshme për instrumentet ekzistuese për mbështetjen e studentëve dhe kjo do të ndihmojë për të ruajtur lidhjet e forta me kompanitë që duan të mbështetin studentët e UEJL-së me bursa.

9.2. Ngrehinat dhe kapacitetet teknike

Pamja madhështore e kampusit, e cila duket edhe nga jashtë që për çdo vit me mjeshtëri vazhdon të ruhet. Duke pas parasysh funksionimin e të gjitha pajisjeve, por edhe gjelbërimi, drunjtë, rrugicat e rrugët, pamja të jep në dijeni që dikush kujdeset me krenari për të. Me plotë besim vazhdojmë të themi se jemi lider në vend e rajon për mënyrën e organizimit të kampusit, organizimit hapësinor dhe pamjes së jashtme, duke u kujdesur për çdo detaj.

Investimi në sisteme të modernizuara për mirëmbajtjen të kampusit vazhdoi edhe këtë vit. Këtë e dëshmon edhe zëvendësimi me drita LED, rritja e sistemit për ujitje automatike të sipërfaqeve të gjelbëruara në afër 12.000 m², mbikëqyrja e vazhdueshme e emitimit të gazrave në ambientet e kampusit, etj. Përmes realizimit të këtyre investimeve dhe participimit në projekte për ruajtjen e ambientit, ne arrijmë dy qëllime: atë të zvogëlimit të kostos së mirëmbajtjes përmes optimizimit

të kostove dhe përgjegjësisë që kemi ndaj shoqërisë përmes emitimit të 0% të gazrave të dëmshëm.

Digjitalizimi i shumë proceseve dhe standardeve me implementim konkret ka vazhduar edhe këtë vit. Tanimë është pjesë e përditshmërisë sonë aplikimi i help deskut përmes së cilit realizojmë kërkesat e stejkholderëve dhe realizojmë planin strategjik me efikasitet dhe efektivitet.

Investimi në rritjen e efijencës energjitike ka vazhduar edhe këtë vit përmes renovimit të disa objekteve me implementimin e roletave më koeficient izolimi më të lartë. Po ashtu është investuar në ruajtjen e ambienteve të brendshme të punës dhe objekteve në përgjithësi përmes ndryshimit të dyshemeve dhe ljerjes pa mos penguar aspak në procesin edukativo-arsimor dhe duke menaxhuar me kohën kur stafi dhe studentët janë në pushime.

Strukturimi i ri i departamentit në vitet paraprake dëshmoj saktë se mënyra e menaxhimit përmes ndarjes së përgjegjësisë dhe autorizimeve në nivel të stafit dhe liderëve është i suksesshëm veçanërisht në implementimin e standardeve bashkëkohore për punë ekipore, të cilën departamenti i mirëmbajtjes vazhdon ta posedojë.

9.3. Kampusi i UEJL-së në Shkup

Kampusi i Universitetit të Evropës Juglindore në Shkup ndodhet në një pozitë simbolike në ndërtesën të quajtur "ura" që lidh pjesën e vjetër dhe të rene të kryeqytetit të Republikës së Maqedonisë. Megjithëse për madhësi e hapësirës, numri i stafit dhe studentëve - në krahasim me kampusin e Tetovës, qendra e Shkupit funksionon me kapacitete administrative dhe infrastrukturore në kohë të plotë, duke ofruar shërbime të plota për të gjithë studentët. Ekziston mbështetje administrative e plotë, nga drejtori dhe stafi i posaçëm i lokacionit dhe nga dega e bibliotekës e lidhur plotësisht me bibliotekën 'Max van der Stoel' në Tetovë për sigurimin e fondit bibliotekarë.

Aktiviteti kryesor i kampusit të UEJL-së në Shkup natyrisht është mësimdhënia dhe mësimi, dhe kështu aktivitetet parësore arsimore të ndërmarra në kampusin e Shkupit bien, në këtë raport, në seksionet e dedikuara për arritjet e fakulteteve individuale. Në Qendrën e Shkupit orët mësimore ofrohen nga të pesë fakultetet dhe në të dy ciklet (nuk ofrohen studime të doktoraturës në Shkup).

Përveç mësimdhënies, konsultimeve dhe provimeve në Kampusin e Shkupit, ka pritur shumë aktivitete formale në amfiteatrin, sidomos konferenca, tryeza të rumbullakëta, promovime librash dhe seminare. Përveç kësaj, Qendra e Shkupit priti shumë takime për Rektoratin, Bordin e Universitetit dhe zyrat e tjera të ndryshme nga kampusi i Tetovës (si Qendra e Karrierës, TechPark, Parlamenti Studentor, Qendra e Zhvillimit të Biznesit, Institutet Hulumtuese, etj.). Kampusi i Shkupit në vitin 2018 përsëri priti finalet për shkollat fillore dhe të mesme "Spelling Bee", në bashkëpunim me Kryqin e Kuq të Ohrit dhe Korpusin e Paqes. Për herë të parë, këtë vit, kampusi i Shkupit organizoi një ekspozitë të posterave të projektit të vitit të fundit nga studentët dhe ata tërhoqën komente pozitive nga të dy palët, studentët dhe vizitorët në Kampus. Rekomandohet që kjo praktikë të vazhdojë dhe të zhvillohet edhe më tutje.

Stafi administrativ ndihmoi në organizimin e vizitave në shkolla të mesme për qëllime promociionale si pjesë e planit të përgjithshëm të marketingut të UEJL-së dhe ndihmoi në të gjitha ngjarjet e lidhura në kampus. Bashkëpunimi me shërbimet e jashtme për sigurinë dhe mirëmbajtjen funksiononte pa probleme. Bashkëpunimi me Ofruesin e Shërbimeve të Mirëmbajtjes ishte i rregullt dhe me cilësi të lartë të ofrimit të shërbimeve. Së fundi, i gjithë stafi i UEJL-së në Shkup ka marrë pjesë në mbledhjet javore të stafit, për të marrë pjesë në përditësimet e rregullta mbi çështjet aktuale dhe planet për veprim dhe funksionim. Kjo ka qenë një praktikë e shkëlqyeshme nga e cila shumë çështje janë zgjidhur në mënyrë të organizuar.

9.4. Burimet njerëzore

Zyra e Burimeve Njerëzore gjatë vitit akademik 2017-2018 konform kompetencave dhe autorizimeve të zyrës është angazhuar të zbatoj planin strategjik të Universitetit lidhur me zhvillimin e burimeve njerëzore, rekrutimin e stafit kualitativ administrativ dhe akademik, duke pasur bazë mbështetëse parimin e mundësive të barabarta. Kujdes i veçantë i është kushtuar edhe trajnimit dhe zhvillimit të stafit të Universitetit në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën për Cilësi.

Zyra e Burimeve Njerëzore gjatë vitit akademik 2017-2018 ka vazhduar me realizimin e procesit të optimizimit të stafit administrativ, proces ky i cili akoma vazhdon. Pas grumbullimit në fazën e parë në formë elektronike të gjitha të dhënat lidhur me kualifikimin, përvojat dhe shkathtësitë për stafin administrativ kemi vazhduar me regjistrimin (evidentimin) dhe sistematizimin e punëve (task log) në baza ditore dhe jemi në proces të revidimit të përshkrimeve të vendeve të punës.

Është vënë në zbatim platforma elektronike e rrogave, vazhdojmë me llogaritjen paralele (elektronike dhe manuale).

Zyra e Burimeve Njerëzore gjatë vitit akademik 2017/2018 konform obligimit ligjor ka organizuar dhe realizuar me sukses kontrollin sistematik mjekësor për stafin në marrëdhënie të rregullt pune.

Universiteti edhe këtë vit me sukses ka vazhduar me udhëheqjen, procedimin dhe promovimin e stafit akademik në tituj mësimore-shkencore. Të gjitha këto aktivitete janë përmbyllur me sukses dhe në kohë.

Për të siguruar nivelin e lartë të cilësisë së burimeve njerëzore të Universitetit rëndësi e veçantë i është kushtuar procesit të rekrutimit të stafit administrativ me kuadro përkatëse, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë Universitetit. Rëndësi e veçantë gjithashtu i është kushtuar edhe kontrollimit, apo respektimit të orarit të punës nga stafi administrativ dhe akademik.

Gjatë vitit akademik 2017-2018, të punësuar janë 255 punonjës të Universitetit të Evropës Juglindore. Ata janë të shpërndarë si më poshtë. Ka 144 anëtar të stafit akademik, 95 prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë, ndërsa 49 të tjerë janë të punësuar me kohë të pjesshme. Janë 111 staf administrativ, prej të cilëve 105 janë të punësuar me kohë të plotë, dhe 6 janë të punësuar me kohë të pjesshme.

Në universitet si staf akademik ka 144 të punësuar; ku 95 janë me angazhim të plotë dhe 49 me angazhim të pjesshëm. Nga stafi akademik me angazhim të plotë, në aspekt të titujve mësimorë –shkencorë kemi këtë shpërndarje, 16 profesorë ordinar; 31 profesorë inordinar; 18 docentë; 10 doktorë shkencash pa titull mësimor-shkencor; 20 magjistra. Nga stafi akademik me angazhim të pjesshëm, në aspekt të titujve mësimorë –shkencorë kemi këtë shpërndarje: 9 profesorë ordinar; 11 profesorë inordinar; 10 docentë; 3 doktorë shkencash pa tituj mësimorë-shkencorë; 8 magjistra dhe 8 me diplomë universitare.

Në vazhdim të dhënat lidhur me thirrjet shkencore të stafit akademik për tre vitet e fundit, ku qartë vërehet rritja permanente e thirrjeve shkencore doktorë shkencash në përputhje me obligimin ligjor, që stafi akademik në marrëdhënie të rregullt pune konform ndryshimeve të Ligjit për Arsim Sipërorë deri me 15. 09. 2015, të kenë thirrje mësimore shkencore .

Në vazhdim tabela me të dhënat për thirrjet shkencore për stafin akademik në marrëdhënie të rregullt pune për tre vitet e fundit :

Scientific title	2015 / 2016	2016 / 2017	2017 / 2018
PhD	79	77	75
MA	31	25	20
BA	0	0	0

Në universitet si staf administrativ ka 111 të punësuar; ku 105 janë me angazhim të plotë dhe 6 me angazhim të pjesshëm. Nga stafi administrativ me angazhim të plotë, 5 janë doktorë shkencash; 16 magjistra dhe 59 me diplomë universitare; ka edhe 25 të punësuar që nuk kanë kualifikim (22 kanë të mbaruar edukim terciar). Nga stafi administrative me orar të pjesshëm ka 1 doktor shkencash; 1 magjistër dhe 4 me diplomë universitare.

Në vazhdim të dhënat – kualifikimi për tre vitet e fundit për stafin administrativ në marrëdhënie të rregullt pune: (tabela)

Scientific title	2015 / 2016	2016 / 2017	2017 / 2018
PhD	4	4	5
MA	16	18	16
BA	66	61	59

Numri më i lartë i të punësuarve në gjashtë vitet e fundit është regjistruar në vitin 2012, kur kishte një total prej 347 të punësuarish (254 me kohë të plotë dhe 93 me kohë të pjesshme). Këta numra janë ulur në mënyrë të vazhdueshme përmes reduktimit të qëllimshëm të mbështetjes në stafin me kohë të pjesshme, optimizime dhe daljet në pension, ose dorëheqjeve. Këto trende janë si në vazhdim: në vitin 2013 gjithsej kishte 320 të punësuar, nga të cilët 249 me kohë të plotë dhe 71 me kohë të pjesshme. Më 2014 gjithsej kishte 300 të punësuar, nga të cilët 229 me kohë të plotë dhe 71 me kohë të pjesshme. Në 2015 gjithsej kishte 285 të punësuar, nga të cilët 223 me kohë të plotë dhe 62 me kohë të pjesshme. Më 2016 gjithsej kishte 278 të punësuar, nga

të cilët 221 me kohë të plotë dhe 57 me kohë të pjesshme. Në vitin 2017 gjithsej ka pasur 261 të punësuar nga të cilët 205 me kohë të plotë dhe 56 me kohë të pjesshme:

Staff	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Full-time	254	249	229	223	221	205
Part-time	93	71	71	62	57	56
Total	347	320	300	285	278	261

9.5. Sistemet e informacionit

Gjatë këtij viti akademik është automatizuar plotësisht llogaritja e rrogave për akademinë, duke u bazuar në angazhimet akademike, të cilat planifikohen me ndihmën e sistemit elektronik për planifikim akademik. Si rezultat i kësaj, tani çdo i punësuar ka pasqyrë të plotë për llogaritjen e rrogës. Kjo pasqyrë e llogaritjes së rrogës tani mund të shikohet në seksionin 'Financat e mia' në portalin MySEEU, gjë që mundëson rritjen e transparencës për financat.

Edhe këtë vit akademik kemi vazhduar me migrimin e sistemit UMS në WEB aplikacion. Në kuadër të kësaj është migruar sistemi elektronik për menaxhim të HelpDesk-ut si dhe moduli për menaxhimin dhe evidentimin e IT pajisjeve

Për departamentin e mirëmbajtjes është zhvilluar plotësisht moduli për planifikimin dhe përpilimin e orarit për punët që përsëriten në cikle të caktuara të rregullta. Sistemi në vete ka të integruara edhe alarme përkatëse që lajmërojnë në kohë për punët që duhet të kryhen. Gjithashtu, për nevojat e departamentit të mirëmbajtjes është zgjeruar sistemi i HelpDesku-ut, ku të punësuarit tani mund t'i paraqesin edhe problemet që i drejtohen këtij departamenti. Është zhvilluar edhe versioni testues për raportet elektronike, që mund të derivohen prej përdorimit të modulit për departamentin e mirëmbajtjes dhe këto raporte do të revidohen bazuar në vërejtjet që do të dalin gjatë përdorimit të të njëjtit.

Gjatë zhvillimit të moduleve në kuadër të WebUMS-it si dhe migrimit të disa moduleve prej portalit MySEEU në WebUMS, ishte e nevojshme të zhvillohet edhe sistemi me të cilin do të menaxhohen edhe privilegjet/qasjet për përdorues të caktuar, ose grupe të përdoruesve në modulet e caktuara. Për këtë arsye u zhvillua edhe moduli për menaxhimin e privilegjeve me të cilin në mënyre precize delegohen dhe revokohen qasjet në modulet përkatëse të WebUMS-it.

Sa i përket sistemit elektronik për prokurime, këtë vit akademik u zhvillua versioni i ri i prokurimit bazuar në dokumentin me kërkesat për ndryshime të sistemit, i cili u përpilua vitin e kaluar. Tani sistemi është i përfunduar dhe i njëjti është në përdorim. Ky sistem tani i mbulon të gjitha aspektet e prokurimeve, përfshirë këtu edhe prokurimet interne, si dhe ato që paraqiten në kuadër të projekteve të ndryshme ku Universiteti është pale. Sistemi i ri ndihmoi në rritjen e efikasitetit në realizimin e prokurimeve.

Këtë vit akademik u realizuar edhe një kërkesë e mëhershme për ndërtimin e një 'repository' elektronik për punimet e magjistraturës dhe doktoratës. Ky sistem tani është i ndërtuar dhe është në përdorim dhe i njëjti është i lidhur me katalogun e bibliotekës së Universitetit. Tani të gjitha

punimet e magistraturës dhe doktoratës janë publike dhe të qasshme nëpërmjet katalogut elektronik të bibliotekës. Ndërtimi i këtij sistemi imponoi që në pjesën e sistemit elektronik për procedurën e diplomimit të shtojmë edhe një pjesë, e cila lidhet me 'repositorin' elektronik të punimeve të magistraturës dhe doktoratës. Tani nëpërmjet këtij sistemi studentit i bëhet me dije për obligimin që e ka që ta dorëzojë në formë elektronike punimin e magistraturës, ose doktoratës.

Sa i përket pjesës së infrastrukturës kompjuterike është punuar në përditësimin e dokumentacionit, si rezultat i situatës së re të krijuar me zëvendësimin e pajisjeve në data qendrën e Universitetit. Kjo rezultoi edhe me revidimin e dokumenteve bazë për 'BackUp' dhe 'Disaster Recovery' pasi që ndryshoi edhe mënyra e krijimit të kopjeve të sigurisë. Tani kemi edhe lidhje të re optike që e mundëson lidhjen direkte të data qendrës primare dhe dataqendrës që gjendet në objektin 816 dhe me këtë e kemi ngritur sistemin për 'Disaster Recovery' në një shkallë më të lartë.

Krejt këto zhvillime, ndryshime dhe përmirësime në fushën e teknologjisë së informacionit dëshmojnë se Universiteti në vazhdimësi demonstroi dedikim në ndjekjen dhe implementimin e praktikave më të mira në botë në fushën e teknologjisë së informacionit.

9.6. Shërbimet e bibliotekës

Biblioteka "Max van Der Stoel" është bibliotekë institucionale në shërbim të qëllimeve hulumtuese dhe arsimore të Universitetit të Evropës Juglindore me hapësirë të përshtatshme në objektin 702. Përveç bibliotekës qendrore në kampusin në Tetovë, funksionojnë edhe bibliotekat degë, si ajo e vendosur në kampusin në Shkup, ashtu edhe bibliotekat degë në fakultetet, si dhe në Qendrën e Gjuhëve. Bibliotekat degë në kampusin e Tetovës funksionojnë të pavarura nga biblioteka kryesore dhe kanë fondin e librave të veçantë. Në kohën e këtij raporti, biblioteka "Max van Der Stoel" (TE dhe SK), gjithsej ka një fond prej 33691 kopje të librave, që mbulojnë 16424 tituj të ndryshëm. Fondi kryesor i bibliotekave është në fushat e lëndëve që mësohen në Universitet, shumica e librave janë në dispozicion për huazim edhe pse veprat e referencës, ku bëjnë pjesë edhe tezat e doktoratës dhe magistraturës, duhet të qëndrojnë në ambientet e bibliotekës. Biblioteka gjithashtu shërben si vend qendror për shfaqje të atyre dokumenteve, që janë vënë në dispozicion të komunitetit para se të paraqiten në Këshillin Akademik të Fakultetit, të tilla si disertacionet të magistraturës dhe doktoratës në pritje të mbrojtjes, ose raportet e recensioneve për proceset promovuese për titull akademik. Në bibliotekë janë në dispozicion edhe materialet informative të printuara nga Bashkimi Evropian, Kombet e Bashkuara, si dhe Banka Botërore për të cilët është siguruar një kënd i veçantë.

Gjatë këtij viti akademik, biblioteka i kreu me sukses punët e saj të rregullta për nevojat e studentëve dhe stafit akademik me shërbimet e nevojshme, pra me libra dhe materiale elektronike, nëpërmjet fondit ekzistues të librave në bibliotekë dhe databazave të disponueshme EBSCO dhe EconBiz. Gjithashtu me saktësi, efikasitet dhe në kohë të duhur janë katalogizuar të gjitha librat e rinj të blerë, bazuar statistikave nga PMB-ja, në periudhën kohore '2017-09-01' - '2018-08-31' janë katalogizuar 606 tituj të ri, ose 1209 kopje të librave. Është me rëndësi të veçantë të ceket edhe procesi i digjitalizimit dhe katalogjizimit të punimeve master dhe punimeve të doktoratës, që ka filluar nga 18 maj 2018 dhe deri tani janë mbi 100 teza të evidentuara, me

qëllim që ato të mund të shihen në katalogun e bibliotekës dhe në repozitorium, ku kanë qasje edhe studiues të jashtëm. Vënia në zbatim të repozitoriumit të materialeve elektronike është kryer me sukses në bashkëpunim, gjegjësisht me angazhimin shumë profesional të Shërbimit të TI-së.

Si iniciativë e bibliotekës dhe në bashkëpunim me dekanët e fakulteteve u themelua komiteti i bibliotekës me përfaqësues të fakulteteve të emëruar nga dekanët përkatës. Me qëllim të mbajtjes së nivelit të lartë të standardeve të shërbimeve të bibliotekës u vendos që, në punimet seminarike studentët të jenë të obliguar të shfrytëzojnë së paku një burim elektronik që ofrohet nga biblioteka. Dhe për të qenë të furnizuar në kohë me materiale të përditësuar, listën e titujve të librave që do të shfrytëzojnë ligjëruesit në semestrin e ardhshëm duhet të dorëzojnë në semestrin paraprak, pasi porositë e librave bëhen vetëm një herë në semestër.

Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi me Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare në Shkup, veçanërisht sigurimin e numrave ISBN dhe ISSN për botimet e reja edhe atë janë realizuar 16 kërkesa, ku si botues është UEJL, për të njëjtët botime në të njëjtën kohë sigurohet edhe CIP (Cataloguing in publication) nga institucioni në fjalë. Duhet cekur që ofrojmë të njëjtët shërbime edhe për profesorët tanë, që janë vetë botues të librave të tyre. Bashkëpunimi me BKU ka vazhduar edhe me aktivitete tjera profesionale, si anëtarë të konsorciumit të bibliotekave publike të RM-së, si anëtarë të IFLA-s dhe si anëtarë të Asociacionit të Bibliotekave të RM-së.

Gjatë gjithë kohës është organizuar fushatë permanente për përdorimin e databazave si të studentët e ri ashtu edhe tek të tjerët. Sipas kërkesave, me lehtësi janë bërë edhe transferet e materialeve të duhura për bibliotekën në Shkup dhe anasjelltas. Gjithë këto veprime janë mundësuar falë stafit profesionist, efikas dhe të devotshëm të bibliotekës. Stafi bibliotekës gjithashtu ndihmon në kontrollin, kthimin dhe rivendosjen e librave që kanë qenë të huazuar nga studentët ose anëtarët e stafit. Në suksesin e punës kanë kontribuar edhe studentët nga programi "Work&Study" të aftësuar nga stafi i bibliotekës.

9.7. Parlamenti dhe Asociacioni Studentor

Parlamenti dhe Asociacioni Studentor gjatë vitit akademik 2017-2018 ka realizuar aktivitetet në kuadër të fushës së vetë të funksionimit, por gjithashtu ka realizuar edhe projekte dhe evenimente, të cilat nuk kanë qenë të parapara në planin e veprimit.

Si fillim, sipas procedurave paraprake janë realizuar zgjedhjet parlamentare në të cilat dukshëm shihet rritja e kandidatëve në zgjedhje, si pasojë e promovimit të aktiviteteve gjatë vitit akademik të kaluar, por gjithashtu të potencialit, i cili mund të realizohet nën ombrellën e kësaj organizate.

Në të njëjtën kohë pjesëmarrja e anëtarëve të PAS në organet universitare është rritur në krahasim me vitin e kaluar. Mirëpo hapësira për përmirësim është përsëri mjaft e madhe.

Veprimtaria që vlen të përmendet e PAS gjatë këtij viti ka qenë: pjesëmarrje në Samitin Global të Liderimit, klubin e Model United Nations, gara të ndryshme në sport në bashkëpunim me Departamentin e Sportit, debate dhe ligjërata me qëllim të zhvillimit të aftësive për sipërmarrësi dhe udhëheqje tek studentët dhe në të njëjtën kohë evenimente për vlerën e rëndësishme të Unionit Evropian, botime të revistës Euroidea, udhëtimet tradicionale me karakter rekreativ dhe

edukativ, aktivitete në kuadër të Ethical Hacking Club, ku u realizuan ligjërata dhe ushtrime jashtë programeve studimore, konferencë dhe tryeza të rrumbullakëta në bashkëpunim me Forumin Rinor Edukativ, ku është diskutuar mbi propozimet, që do të jepen për Ligjin e Arsimit të Lartë në fushën e organizatave studentore, pjesëmarrje në Konferencën për Leadership të organizuar nga ana e USAID, pjesëmarrje në diskutimet "Brain Drain in Macedonia" të organizuar nga ana e Këshillit Rinor të Ambasadës së SHBA-ve në Shkup, ndihmë në organizimin e evenimentit të iniciativës "Мрдни со прст," në hapësirat e UEJL në kampusin në Tetovë, aksione humanitare, si dhe pjesëmarrje në mbledhjet e realizuara për themelimin e Rotaract-Tetovë.

Në përgjithësi ky vit karakterizohet si mjaft produktiv, mirëpo është hasur nevoja për përmirësimin e mjeteve të motivimit të studentëve për pjesëmarrje në aktivitetet jashtë programeve studimore.

Pengesa që duhet të theksohet me të cilën PAS është ballafaquar është gjatë Zgjedhjet për Rektor të universitetit. Gjatë kësaj periudhe ka pasur mjaft tentativa në mënyrë direkte dhe indirekte nga individë dhe subjekte të brendshëm, por gjithashtu edhe të jashtme për të ndikuar te anëtarët e PAS-it për devijimin e qëllimit dhe misionit, që kjo organizatë synon. Mirëpo, siç është shpallur edhe nga ana e PAS-it, organizata jonë mori qëndrim neutral në këto zgjedhje dhe me çdo kusht tentoi që të pamundësojë realizimin e këtyre tentativave. Këto raste nuk janë paraqitur për shkak të mungesës së fakteve të shkruara dhe mos pranimit të anëtarëve të PAS-it për denoncimin e po të njëjtave.

9.8. Sporti dhe rekreacioni

Edhe në vitin akademik 2017/18, Sektori për sport dhe rekreacion në kuadër të UEJL-së, ka qenë mjaft aktiv në organizimin e aktiviteteve sportive në shumë sporte, duke iu mundësuar studentëve t'i shfrytëzojnë kapacitetet dhe kushtet që Universiteti i ofron për zhvillimin e këtyre aktiviteteve.

Në kampus, çdo ditë janë organizuar aktivitete intensive sportive në futboll, volejbol, basketbol, fitnes, tenis, shah, ping-pong dhe kurse për vallëzim për gjithë studentet dhe stafin. Në orët e vona të mbrëmjes është bërë kyçja e reflektorëve në mënyrë që studentët të mund pa pengesa t'i ushtrojnë aktivitetet e tyre sportive. Përveç këtyre aktiviteteve, të cilat janë të përditshme, ka patur edhe aktivitete, të cilat organizohen periodikisht edhe atë: turne të ndryshëm në futboll, ping-pong dhe shah. Vlen të theksohet edhe organizimi i turneut në futboll të vogël për shkollat e mesme të Tetovës, që tashmë tradicionalisht organizohet në kampusin e universitetit.

Në ditën e hapur të UEJL-së, Sektori për sport dhe rekreacion organizoi aktivitete sportive në futboll, basketbol, volejbol dhe ping-pong, të cilat kishin karakter revijal.

Po ashtu, ekipi i futsallit ishte pjesëmarrës në Ligën e Parë të Maqedonisë në futsall, ku e përfaqësoi UEJL-në. Stafi i UEJL-së, morri pjesë në Ligën Institucionale Komunale të Tetovës në futboll të vogël. *Me studentët ishim pjesëmarrës në garat ndëruniversitare në sporte të ndryshme.* Gjithashtu, ishim nikoqir i garave republikane në ping-pong, të organizuara nga Federata e Ping-Pongut.

Për nder të festave të nëntorit, si dhe 16 vjetorit të themelimit të UEJL-së, Sektori për sport në UEJL, organizoi turneun tradicional "MEMORIALI-ARBËR XHAFERI"

Është me rëndësi të theksohet se Sektori për sport i UEJL-së ka organizuar edhe turne në ping-pong dhe futboll edhe për studentët e UEJL-së në Shkup. Për të siguruar kushte të mira për sport për studentët e UEJL-së Shkup, kemi nënshkruar kontratë për shfrytëzimin e sallës dhe pishinës "Boris Trajkovski", të cilën studentët kanë mundur ta shfrytëzojnë për sport dhe rekreacion. Në vitin e kaluar akademik Sektori për sport dhe rekreacion pranë UEJL-së për here të parë organizoi turneun në shah "Kupa Arbër Xhaferi", i cili pati karakter rajonal, duke pasur parasysh se në këtë turne pati pjesëmarrës nga Serbia, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia.

Marrë në përgjithësi, viti akademik 2017/18, mund të cilësohet si tejet i suksesshëm për Sektorin për sport dhe rekreacion të UEJL-së. Gama e gjerë e aktiviteteve sportive, si dhe kapacitetet dhe kushtet të cilat i ofron kampusi universitar, kanë ndikuar që të rritet edhe numri i studentëve, të cilët duan të merren me aktivitete sportive. Ky trend rritës, në të ardhmen do të na imponojë objektiva që kanë të bëjnë me zgjerimin e kapaciteteve sportive në mënyrë që të mundemi t'iu përgjigjemi nevojave të studentëve, të cilët duan që kohën e lirë ta kalojnë duke u marrë me sport. Për UEJL- në si objektiv për të ardhmen ngelët ndërtimi i sallës sportive, gjë që do të ndihmonte në rritjen e numrit të studentëve që do të merren me sport.

10. Konkluzionet

Universiteti i Evropës Juglindore mban një pozitë të respektuar në mjedisin e arsimit të lartë në Ballkan. Ai vazhdon të tërheqë aplikantë me cilësi të lartë në të tre ciklet e studimit; mbanë normat e punësimit të respektuar në nivel rajonal për të diplomuarit; vazhdon të merr një financim të vlefshëm financiar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë; dhe mbetet universiteti jo shtetëror më lartë i ranguar në vend, sipas renditjes së Shanghai Jiao Tong.

Ky raport nuk ka për qëllim vetëm të theksojë pikat e forta të UEJL-së, por edhe të identifikojë dobësitë e tij. Për fat të keq, është e vërtetë se rekomandimet e sakta të bëra në Raportin e Vetë Vlerësimit 2016-2017 mbeten të zbatueshme për këtë raport. Për këtë arsye ato përsëriten fjalë për fjalë, si probleme të vazhdueshme dhe të rëndësishme që Universiteti duhet t'i adresoj:

- ★ ta stabilizojë regjistrimin e studentëve në ciklin e parë;
- ★ ta ruajë pozitën udhëheqëse rajonale në studimet e ciklit të dytë dhe të tretë;
- ★ t'i diversifikojë burimet e të ardhurave nëpërmjet bashkëpunimit inovativ me partnerët e biznesit dhe social;
- ★ ta formalizojë subvencionin bujar të qeverisë në një marrëveshje të strukturuar dhe të rregullt;
- ★ ta përmirësojë shkallën e diplomimit në kohë;
- ★ t'i forcojë burimet e hulumtimit (qasje në bazën e të dhënave), për studentët në studimet pasuniversitare dhe stafin;
- ★ të zhvillojë një asociacion aktiv të Alumnit.

Universiteti i Evropës Juglindore vazhdon të përballlet me vështirësitë dhe pasiguritë, por jo më shumë se institucionet e tjera të krahasueshme në Republikën e Maqedonisë. Kjo është një epokë sfiduese për universitetet në mbarë botën. E konsideruar në kontekstin e tij rajonal, UEJL mbetet i vendosur për të përfituar nga pikat e forta të njohura: dy kampuse të shkëlqyeshëm në Tetovë dhe Shkup; një angazhim të fortë dhe të avancuar për mekanizmat e sigurimit të cilësisë; një staf i përkushtuar i mësimit dhe administratorëve; një nivel i lartë i ofrimit të lëndëve digjitale dhe përdorimit të burimeve digjitale; pozitive nëse përkrahen alumni joformalë; dhe dallimi më i dukshëm institucional i UEJL-së - angazhimi themelor për arsimim të cilësisë së lartë pavarësisht nga gjuha amtare, përkatësia etnike, gjinia, feja apo pikëpamjet politike. Është synimi eksplisit i Universitetit që të vazhdojë të mbështesë këto vlera, përparësi konkurruese dhe angazhime afatgjata, duke besuar se ato janë elementet, që do të sigurojnë suksesin e ardhshëm të studentëve, arritjet e stafit dhe veçantinë institucionale dhe stabilitetin.

Anëtarët e komisionit të vetëvlerësimit

- ★ Dr. Andrew Goodspeed – kryetar;
- ★ Dr. Xhevair Memedi – zëvendës- kryetar;
- ★ Dr. Vladimir Radevski – anëtar;
- ★ Dr. Veronika Kareva – anëtar;
- ★ Dr. Adrian Besimi – anëtar;
- ★ Dr. Gadaf Rexhepi – anëtar;
- ★ Dr. Sami Memeti – anëtar;
- ★ Dr. Agron Rustemi – anëtar;
- ★ Dr. Veli Kreci – anëtar;
- ★ Ms. Donika Luma – anëtar student

(Komiteti dëshiron gjithashtu tu shpreh mirënjohje për kontributin e dhënë Burim Ismailit për përmbytjen e këtij raporti, si dhe Daniela Ilievskës dhe Rexhep Xheladinit për përkthimin.)